



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:239978
Datë: 21.01.2022
Numri i dokumentit: 02629494

C.nr.2215/2012

GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Përparim Zeka, në çështjen juridike kontestimore të paditësit S. K., me adrese fshati M., Komuna Prishtinë, kundër të paditurve V. J., nga Graçanica dhe V. L., nga Graçanica, për Dorëzim në posedim, jashtë seance me datë 20.01.2022 mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET së është tërhequr padia e paditësit S. K., nga Prishtina ,kundër të paditurve V. J., nga Graçanica dhe V. L., nga Graçanica, për Dorëzim në posedim, lënda sipas shenjës C.nr.2215/12.

A r s y e t i m

Paditësi S. K., nga Prishtina ka ushtruar padi në këtë gjykatë, kundër të paditurve V. J., nga Graçanica dhe V. L., nga Graçanica, për Dorëzim në posedim.

Me date 20.01.2022 Gjykata ka caktuar seancë gjyqësore, në të cilën ka prezantuar i padituri V. J., mirëpo nuk ka prezantuar paditësi S. K., ku nga fletë kthesa për dorëzim personal konstatohet se paditësi është ftuar në mënyrë të rregullt, ftesën e

ka pranuar me datë 13.01.2022, mirëpo në seance nuk prezanton dhe mos prezencën e tij nuk e ka arsyetuar.

Gjykata në kuptim të dispozitave nga neni 409.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si ne dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.2215/12, data 20.01.2022

Gjyqtari
Përparim Zeka

KËSHILLË JURDIKE:

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.